

NJOFTIM

PËR REKRUTIMIN E NJË EKSPERTI TË JASHTËM TË SPECIALITETIT MJEK PSIKIATËR

Në kuadër të Planit të Inspektimeve të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), është e nevojshme pjesëmarrja e një mjeku psikiatër në grupin e inspektimit për të monitoruar shërbimet e ofruara në disa spitale psikiatrike/shëndetit mendor si dhe institucione të vuajtjes së dënimit ku trajtohen të dënuarit /paraburgosurit.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon të rekrutojë një ekspert/e të specialitetit mjek psikiatër, për periudhën *kohore 27-31 Maj 2109*.

Përshkrimi i punës

Detyrat e ekspertit të jashtëm të specialitetit mjek psikiatër do të jenë Monitorimi i:

- ✓ I.E.V.P. Zahari Krujë, ku strehohen dhe trajtohen kryesisht personat që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”.
- ✓ Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtretër në Shkodër.
- ✓ Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci”, Elbasan.

Vizitat monitoruese në këto qendra do të kenë si qëllime specifike vlerësimin e:

- Nivelit të respektimit të të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor, në mjediset e shërbimit mendor të specializuar me shtretër, të përcaktuara në ligjin nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”.
- Procedurat e kryerjes së shkrimeve vullnetare.
- Ligjshmërinë e masave shtrënguese të përdorura dhe procedurat e ndjekura për kufizimin fizik.
- Kushtet në të cilat mbahen dhe trajtohen pacientet.
- Cilësinë e trajtimit mjekësor dhe rehabilitues
- Nivelin e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit mbi gjetjet e konstatuara gjatë vizitave të mëparshme

Pas përfundimit të vizitave monitoruese, eksperti i jashtëm duhet të përgatisë një raport të detajuar mbi gjetjet dhe rekomandimet që duhet të adresohet nga institucionet përkatëse, raport i cili duhet të miratohet paraprakisht nga Komisioneri i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT).

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve

Kandidatët që duan të aplikojnë për këtë pozicion, duhet të plotësojnë kriteret dhe procedurat e mëposhtme:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Mjekësi, në specialitetin mjek psikiatër;
- Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë profesionale;
- Të ketë njohje të thellë të gjuhës shqipe dhe angleze, në të folur dhe në të shkruar;

- Të ketë aftësi organizative dhe administrative si dhe veçanërisht aftësi komunikimi;
- Të ketë standarde të larta të integritetit dhe përvojës në trajtimin e informacionit konfidencial
- Të zotërojë automjet dhe patentë dhe të jetë i/e gatshme për të udhëtuar;
- Të përmbushë afatet;
- Të ketë fleksibilitet, aftësi të forta adaptimi dhe aftësi për punë në ekip
- Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet Microsoft Word, Excel, si dhe njohuri të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit (IT).

Periudha dhe vendndodhja

Afati i rekrutimit do të përfshijë periudhën *27-31 maj 2019*, dhe eksperti i jashtëm do të kryejë detyrat e përcaktuara më sipër, sipas kalendarit të lëvizjeve të grupit të monitorimit të Drejtuar nga Komisioneri i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT).

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit:

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Letër motivimi;
- Curriculum Vitae (CV);
- Kopje të diplomës;
- Kopje të librezës së punës;
- Dëshmi të gjuhës së huaj (nëse ka);

Aplikimet duhet të dërgohen në rrugë elektronike në [adresen: msanxhaku@avokatipopullit.gov.al](mailto:msanxhaku@avokatipopullit.gov.al), ose ne zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Institucioni i Avokatit të Popullit

Blv. "Zhan D'Ark", nr.2, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të Drejtorisë së Burimeve Njerezore, Finances dhe Pritjes se Qytetarit

Afati

Aplikimet pranohen deri në datë **24.05.2019, ora 16:30**. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumenteve vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.